



GEKOS

**ARKA FISKALE
DP-500D**

UDHËZIM PËR OPERATORIN

“Enternet”

Tel: 038 603 232

Fax: 038 603 229

service@enternet-ks.com

www.enternet-ks.com

Zona industriale p.n. Fushë Kosovë

TË PËRGJITHSHME

Korrigjimi i çmimit te futur gabim bëhet duke shtypur tastin [C] dhe vendoset çmimi i rregullt.

Anulimi i shitjes se fundit behet duke shtypur tastin [VD], tasti [STL] tregon shumën e ndërmjetme (shitjet e bëra pa u mbyllur kuponi). Tregimi i gjendjes se baterisë, datës apo orës behet duke shtypur tastet [OFF] [.]

Avancimi i letrës behet duke shtypur tastin [↑].

Kur mbaron letra apo kemi probleme ne vendosjen e saj ne ekran paraqitet [NUK KA LETER].

N.q.s. ne arke paraqitet ndonjë mesazh gabimi, ai korrigjohet ne shumicën e rasteve duke shtypur butonin [C].

SHENIM: Kur kasa është programuar me çmime me dy shifra mbas presjes dhjetore (.00), duhet treguar kujdes ne saktësinë e shifrës qe vendoset. Kjo për rastet e çmimit, sasisë dhe kodit te artikullit.

P.sh. Çmimi i artikullit është 2 Euro. Veprohet kështu:

a – Shtypet 2, ne ekran paraqitet 0.02 (jo e sakte)

b – Shtypet 2 dhe pikë (.), ne ekran paraqitet 2.00 (e sakte)

Arka ndizet duke shtypur tastin [ON] për 2 sekonda. Ne ekran afishohet “ OFF “.

Arka fiket duke shtypur tastin [0] kur jemi ne regjimin [OFF].

Për te kaluar nga çdo regjim ne regjimin [OFF] mjafton te shtypet tastin [OFF].

REGJIMI I SHITJES (R)

Ne regjimin “ OFF “ shtypet tasti [1] ne ekran paraqitet:

R

FJALEKAL -----

Shtypet fjalëkalimi i operatorit 1- 30 dhe pastaj [TOTAL] ne ekran paraqitet 0(0.00) ne varësi te programimit .

Shtitja realizohet si me poshtë:

- a. Shtypet çmimi (deri me 8 shifra)
- b. Shtypet Nr. i artikullit [1/11] - [10/20] dhe [SHIFT] [1/11] – [10/20] për artikujt 11-20 .

Kur janë programuar me shume se 20 artikuj shtypet:

[Çmimi] [PRC] [kodi i artikullit] [PLU]

Ne te njëjtën mënyre veprohet për shitjen e dyte, te trete etj.

- c. Shtypet tasti [STL] , paraqitet nen totali i kuponit, shtypet vlere e paguar.
- d. Ne fund shtypet tastin [TOTAL] dhe del kuponi.

e. Nëse dëshirohet një kopje e faturës shtypet [PY]

Shtitja për disa cope ose pjese te artikullit behet duke shtypur sasinë, pastaj tastin [X] dhe veprimet e tjera kryhen si me larte (a,b,c,d).

Nëse paraprakisht shtypet tasti <STL>, shënohet vlere dhe më pas përdoret <SHIFT> + <%+>,do të shkaktojë që vlere paraprakisht e shënuar të shtohet në nen-totalin.

Nëse paraprakisht shtypet tasti <STL>, shënohet vlere dhe më pas përdoret <SHIFT> + <%->,do të shkaktojë që vlere paraprakisht e shënuar të zvogëlohet në nen-totalin.

RAPORTI FINANCIAR DITOR (Z)

Është i detyrueshëm dhe behet duke shtypur tastet:

[OFF] [3] [3] [0] [TOTAL] [TOTAL]

Pasi printohet raporti financiar, ne fund shkruhet “**arka është pastruar**”. Të dhënat janë ruajtur ne Memorien Fiskale, ne një bllok me numër rendor te veçante, numër qe printohet ne fund te kuponit.

LEXIMI I MEMORIES FISKALE

Shtypet fillimisht: [OFF] [3] [3] [0] [TOTAL], me pas mund te bëhen raportet e mëposhtme:

a- RAPORT FISKAL PERIODIK I DETAJUAR Z behet duke shtypur tastet:

[1] [STL] [dd mm vv] [X] [dd mm vv] [VD]

b- RAPORT FISKAL PERIODIK Z PERMBLEDHUR behet duke shtypur tastet:

[3] [STL] [mm vv] [X] [PLU]

ku dd-data; mm-muaji; vv-viti (fillimi i muajit) DD-data; MM-muaji; VV-viti (fundi i muajit)

c- RAPORT FISKAL PERIODIK I DETAJUAR Z nga blloku (n) deri ne bllokun (m) behet:

[2] [STL] [n] [X] [m] [VD]

d- RAPORT FISKAL PERIODIK Z PERMBLEDHUR nga blloku (n) deri ne bllokun (m):

[2] [STL] [n] [X] [m] [PLU]

RAPORTE te tjera te arkës (PA FSHIRJE –X)

Bëhen duke shtypur tastet: [OFF] [2] [3] [0] [TOTAL]

Duke shtypur një nga tastet përkatës, arka realizon raportet si me poshtë:

PLU - Raport sipas grupeve dhe sektorëve te artikujve.

TOTAL - Raport ditor fiskal **X**

STL - Raport sipas operateve

PY - Raport sipas artikujve

PLC - Raport për te dhenat e artikujve, parametrat.

%+ - Raport shërbimi për MF

[1/11] - Raport periodik sipas llojit te pagesës.